



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 14 - 2009
Prishtinë, më 27 prill 2009, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Bajram Kosumi, Kolë Berisha, Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Adem Hajdaraj dhe Armend Zemaj.

Munguan: Branislav Grbiq, Dzezair Murati dhe Selvije Halimi.

Të pranishëm: Ramadan Islami – OSBE, Rrezarta Ahmeti, Reshit Gashi – NDI, Lejla Selimi - OSBE, Lumnije Murati – ZPRK, Vlora Marmullaku, Naim Hajdari - EULEX, Kujtim Aliu dhe Mustafë Nuhiu - Kuvendi i Kosovës.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit me këtë:

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 23 prillit 2009;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Institutit gjyqësor të Kosovës;
4. Shqyrtimi i propozimvendimit të Ministrisë së Drejtësisë për dhënien e provimit të jurisprudencës;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – Në fillim të mbledhjes i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi përfaqësuesit e mediave, organizatat që e mbështesin punën e Komisionit dhe i njoftoi për rendin e ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 23 prillit 2009

Kryetari - I pyeti anëtarët e Komisionit a kanë vërejtje eventuale për procesverbalin.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës

Në mbledhjen e Komisionit, me ftesë, ishte i pranishëm edhe drejtori i Institutit Gjyqësor të Kosovës, z. Lavdim Krasniqi. Kryetari i dëshiroi mirëseardhje në emër të Komisionit dhe shtoi se arsyeja e ftesës është diskutimi për Raportin e Institutit Gjyqësor të Kosovës. Për këtë raport kryetari hapi debat.

Drejtori i Institutit Gjyqësor të Kosovës, z. Lavdim Krasniqi - E mori fjalën dhe e falënderoi Komisionin për ftesën. Diskutoi për historikun e Institutit, për ligjet në bazë të të cilave punon dhe funksionon ky institut. Vuri në pah se ky është raporti i parë që i paraqitet Komisionit. Diskutoi edhe për punën e Institutit, sidomos sa i përket arsimimit ligjor dhe trajnimit për prokurorë dhe gjyqtarë. Shkoqiti pjesë të këtij raporti para anëtarëve të Komisionit, duke filluar nga historiku, nga baza legale e funksionimit të këtij instituti dhe nga çështje të tjera. Shtoi se mund të diskutojmë edhe për Raportin.

Kryetari - E falënderoi drejtorin e Institutit për Raportin, që përherë të parë paraqitet në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi. Raportin do ta procedojmë për seancë plenare. E kam lexuar Raportin dhe i kam disa vërejtje. Në Raport nuk kam vërejtur se flitet për funksionimin e Këshillit Drejtues. Sa anëtarë i ka ky këshill, sa i mungojnë, a është funksional? Është mirë të dihen edhe emrat e anëtarëve. Ky raport do të përcillet në seancë plenare. Në të nuk flitet për buxhetin, por është shumë e rëndësishme të dihet si janë shpenzuar mjetet. Në Raport përmenden shumë trajnime, por ne si Komision është mirë t'i dimë me emër se kush janë ligjëruesit, kush i mban këto trajnime, sepse përkundër shumë trajnimeve lëndët nëpër gjykata nuk po zgjidhen.

Armend Zemaj – E falënderoi drejtorin e Institutit për raportin e paraqitur në Komision, që mendohet se është i mirë. Mund të ishte edhe më i mirë, po të ishin përfshirë në të edhe emrat e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe mosha e atyre që iu kanë nënshtruar provimit për vitin 2008. Për buxhetin dhe financat duhet të ishte një raport shtesë, sepse në bazë të Raportit shihet se janë mbajtur shumë trajnime.

Adem Hajdaraj - Theksoi se kandidatët që i janë nënshtruar provimit janë shprehur se ligjëruesit nuk kanë qenë korrektë në testin me shkrim, por edhe në atë me gojë. Edhe kontrollimi i testeve ishte joadekuat.

Adem Salihaj - Vuri në dukje se Raporti është i mirë, por kërkoi raport të të hyrave dhe të shpenzimeve. Veçoi se trajnuesit nuk është në rregull të jenë nga Këshilli Drejtues. Pyeti a janë trajnimet vetëm për prokurorë dhe për gjyqtarë apo edhe për juristë të tjerë.

Kryetari - Për herë të dytë i hapi edhe disa çështje, si: trajnimet e mbajtura në ditët e punës, ardhja në trajnim me vettura zyrtare, dhe si ndikoi kjo në punën e prokurorive dhe të gjykatave. Gjithashtu pyeti se kush i zëvendëson administratorët e gjykatave, kur tri ditë pune marrin pjesë në trajnime.

Drejtori i Institutit - I falënderoi kryetarin dhe anëtarët e Komisionit për çështjet e ngritura dhe i siguroi se do të marrin një raport shtesë për takimet dhe përbërjen e Këshillit Drejtues të Institutit. Lidhur me angazhimin e trajnerëve shtoi se ka dy lloj trajnerësh: *ad hoc* dhe të përhershëm. Trajnerë mund të jenë edhe anëtarët e Këshillit Drejtues. Lista e trajnerëve miratohet në fillim të vitit në konsultim me Këshillin Programor, ndërsa për buxhetin do ta paraqesim një raport shtesë. Moshë e tyre nuk është e caktuar me ligj. Kriteret për trajnerë caktohen me statut. Drejtori më tuje theksoi se trajnimet janë mbajtur në ditët e punës, por si Institut jemi përpjekur të mos pengojmë në punën e gjykatave e të prokurorive, sepse jemi në kontakt të përhershëm me kryetarët e gjykatave dhe me kryeprokurorët. Tha se do të keni një raport shtesë për të gjitha çështjet e ngritura dhe i falënderoi edhe një herë të pranishmit.

Kryetari – E falënderoi drejtorin e Institutit për Raportin. Komisioni do të vendosë a do ta procedojmë për Kuvend me këto vërejtje apo do të kërkojmë raport shtesë.

Armend Zemaj - Propozoi që vërejtjet e Komisionit t'i dërgohen me shkrim Institutit, sepse edhe ai ishte i mendimit se duhej të përgatitej një raport shtesë.

Adem Salihaj - Kërkoi që raportit t'i bashkëngjitet raporti financiar. Për këtë ishin të mendimit edhe ata të Institutit.

Ibrahim Makolli – Theksoi se anën buxhetore duhet ta shqyrtojë Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Bajram Kosumi – Shtoi se pajtohet me mendimin tonë, por duhet të njoftohemi me shkrim nga Instituti për çështjet e shtruar nga Komisioni dhe kërkoi që përgjigjet e Institutit të jenë me shkrim.

Kryetari – Vuri në pah se të gjithë pajtohem të kërkojmë nga Instituti raport shtesë për çështjet e ngritura.

4. Shqyrtimi i propozimvendimit të Ministrisë së Drejtësisë për dhënien e provimit të jurisprudencës

Kryetari – Ishte i interesuar që ky propozim të shkonte në seancë plenare, sepse kjo ishte hera e pestë që diskutonim për propozimvendimin e Ministrisë së Drejtësisë për dhënien e provimit të jurisprudencës. Tash kemi edhe kandidatë të tjerë, si p.sh.: Fetije Sadiku që nuk e ka sjellë biografinë (CV- në) e vet, kurse Ruzhdi Berisha ka sjellë edhe shkresa që ka punuar si gjyqtar i çështjeve civile.

Adem Salihaj - Theksoi se për kandidaten, Fetije Sadiku, nuk kemi fare biografi (CV), ndërsa rasti i kandidatit Qerim Qerimi është i njëjtë me atë të Vjosa Osmanit, sepse edhe ky është këshilltar në Ministrinë e Punëve të Jashtme, ndërsa Ruzhdi Berisha nuk i plotëson kushtet e parapara me ligj. Shtoi se ky propozim le të shkojë në Kuvend me arsyetimin se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet.

Bajram Kosumi – Vuri në pah se edhe ai ishte që ky propozim të shkojë në Kuvend, por duhet ta kemi rekomandimin tonë që të votohet apo të mos votohet.

Adem Hajdaraj - Tha se anëtarët e Komisionit kanë të drejtë, por unë jam që të gjendet një mjedis, sepse e pësojnë kandidatët, ngase nuk kanë mundësi ta japin provimin e jurisprudencës.

Ibrahim Makolli - Propozoi të hartohet një raport i hollësishëm për këtë çështje dhe të lexohet në Komision. Me këtë propozim u pajtuan edhe anëtarët e Komisionit.

Procesverbali e hartoi stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni